

MENELLA TOTONI

E FOLMJA E BREGDETIT TË POSHTËM II

FJALËFORMIMI

§ 64 — Në këtë paragraf do të ve në dukje ndonjë prapashtesë dhe parashtesë produktive në këtë të folme ose ndonjë tjetër që, ndonse e kam hasur rrallë, më është dukur me interes.

Prapashtesa *-esh* u ngjitet temave të emrave mashkullorë për të formuar femëroren : *agesh* (N. = gruaja e agait), *ujkesh* (= *ujkonjë*).

Mjaft të përhapura (sidomos në sferën e terminologjisë blegtorale) janë prapashtesat *-ash*. dhe *-ush*. Këto u ngjiten temave të emrave femërorë për të formuar mashkulloren ; *larmushkash* (fem. *larmushk*), *kenash* (fem. *ken*) *mëllënjash* (fem. *mëllënj*), *zebásh* (fem. *zeb*) ; *larúsh* (fem. *lar*), *verdhash* (fem. *verdh*) etj.

Prapashtesa *-ash* bashkohet dhe me tema mbiemërore ; rezultati është përsëri mbiemër. Ajo që të tërheq vemendjen, është fakti që në shembujt që kam regjistruar, theksi nuk është çvendosur në prapashtesë : pjepër *zemërkùqash*, pjepër *zëmërvérdhash*.

Prapashtesa *-ush* te fjala *miùsh* (B. = mi i vogël) ka kuptim zvogëlonjës.

Në sferën e terminologjisë blegtorale haset shpesh edhe prapashtesa *-ër*. Kjo u ngjitet temave emërore ; rezultati është një mbiemër që karakterizon emrat *çjap*, *keç dhi*, *dash*, *dele* etj. nga pikëpamja e ngjyrës, *brirëve* etj. ; *çjap i mëllënjër* (= *çjap në ngjyrë të zezë*), *dhi e mazhër* (= *dhia me faqet në ngjyrë të zezë*), *dash i shitër* (= *dash pa brirë*), *dele e bejkër* (= *delja në ngjyrë të bardhë*) etj.

Prapashtesa *-jar* bashkohet me tema foljore dhe emërore ; rezultati është një emër vepronjës : *cangadhjar* (= *çobani që ruan cangashet*), *kánosjar* (= *bekçi i fshehtë*). Kjo prapashtese haset dhe në të folme të tjera labe dhe në çamërishte.

Interes paraqet prapashtesa *-ej(ë)*, sinonimike me prapashtesën *-esë*, që e kam dëgjuar në Nivicë : *rrobavet djalit shtreja mbuleja* u thon/.

Mjaft aktive është në Nivicë prapashtesa *-ishte* dhe sinonimikja e saj *-rishte*. Këto bashkohen me tema emërore ; rezultati është një emër që tregon vend : *arishte* (= *vend me ara*), *gropishte* (= *vend i futur, gropë*), *qafishte* (= *vendi në një qafë*) ; *gropërishte* (= *gropishte*), *numerishte* (= *vendi, ku ngrihen nome*), *llakërishte* (= *emërtim toke me kuptim të paditur*).

Karakteristike për të folmen e Bregut të Detit e përgjithësisht për të folmet labe është prapashtesa *-i-j(ë)*²⁴ Kjo prapashtesë bashkohet me tema foljore dhe emërore. Duke u bashkuar me tema foljore, formohen emra që

(24) Siç është spieguar edhe në skicën "E folmja e Zagorisë" (B. SH. SH. Nr. 1, 1962; fq. 194) prapashtesa është *-j(ë)*, ndërsa *i* është një anaptiks.

emërtojnë procese veprimesh, ose rezultate veprimesh: a) *deki* (= dekje); *lindij*, *kullotij*, *marrij*, *ngritij*, *rrotij*, *orasij*; b) *lutij* (= lutje), *plasij*, *veshij* etj.

Me tema emërore prapashtesa *-i-j(ë)* bashkohet rrallë; rezultati është një emër ose mbiemër: *mbërthekij*, dardh *elbij* (B).

Në të folmen e personave të shkolluar e të dalë, si rezultat i ndikimit të gjuhës së shkruar dhe të të folmeve të tjera, prapashtesa *-i-j(ë)* shpesh zëvendësohet nga prapashtesa *-je*: merrem me *trapesje* / do ti japëm pas gjëndjes /, lug *ndarjes*, pas kësaj *ndodhje* u çpërngul /.

Në Borsh në nja dy fjalë del prapashtesa *-ë-l*, që është karakteristike për çamërishten: *gërthël*, dardh *kuqla*.

Me një përdorim jo dhe shumë të gjerë, veç jo dhe të rrallë, haset këtu edhe prapashtesa *-z(ë)*, e cila kuptimin e saj primar të zvogëlimit, të përkëdhelisë e ruan në ndonjë rast si: *frënjëz* (= bishti i kokrrës së fikut), *vërëz* (= vrimë e vogël dhe e thellë).

Në disa raste *-z(ë)* nuk e ndryshon kuptimin e fjalës rrënjë: *përrallëz* (= përrallë), *xjebez* (= zgjebe).

Në disa raste të tjera me këtë prapashtesë formohen emra me kuptim të ri: *bishtez* (= nënbishte), *gojez* (= sëmundje bagëtish), *kthenez* (= fik i bërë shumë, që varet).

Prapashtesa *-z(ë)* haset shpesh edhe në toponomastike: *Kotécez*, *Kuqeza*, *Samález*, *Shález*, *Shkállëz*, *Vilëz*.

Prapashtesa *-thi* u ngjitet ndajfoljeve, ose ndonjë pasthirme; nuk e ndryshon kuptimin e fjalës rrënjë, përkundrazi sikur e forcon atë: *mezithi*, *së prapthi*, *lumthi*. Kjo u ngjitet dhe temave emërore; rezultati është një ndajfolje: *çinithi*, *kalthi*, *topthi*.

Me tema ndajfoljore bashkohet edhe prapashtesa *-azi* (P., N.); fjala e re ruan kuptimin e temës: *qetazi* (qetë), *këtejazi* (=këtej). Ndajfoljeve kompozita *mbillasimazi* (=symbyllur) dhe *mirkëshillazi* (ju i liri mirkëshillazi / = në mirëkuptim) prapashtesa *-azi* u jep kuptimin e mënyrës.

Prapashtesa *-isht* u ngjitet temave mbiemërore; rezultati është një ndajfolje mënyre e në ndonjë rast edhe ndajfolje kohe: *komitërisht*, *vogjëlisht*, *lashtërisht* i thoshën *dufek* / (=lashtit).

Si prapashtesë që u jep disa foljeve një kuptim të kundërt, përdoret ç-: *çkrij*, *çkarkoj*, *çkoqit*, *çit* (<çqit), *çkul*, *çkrej* etj.

Në këtë të folme në dallim nga toskërishtja e përbashkët nuk marrin prapashtesa fjalët: *daj* (=ndaj), *gjaj* (=ngjaj), *xij* (=nxij), *dij* (=gdhij), *des* (=vdes), *gjedh* (gjeth — B. = zgjedh).

SINTAKSA

§ 65 — Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën, kur kjo është një emër kolektiv, bëhet më shumë në përputhje me kuptimin e kryefjalës: a) na disin fëmija /, do gëzojnë fëmija /, fshati u ngren e van e rrethuan /, u mblofdeh gjitonia /; b) dhe fshati përpjetë dolli /, Kurveleshi na mori gjën e gjallë /.

§ 66. — Një pjesë e emrave mashkullorë, që e bëjnë shumësin me mbarësën *-e*, marrin në shumës mbiemra të gjinisë femërore. E ndërrojnë gjininë një pjesë e madhe e emrave mashkullorë të huajtur nga turqishtja, emrat e prejardhur me prapashtesën *-im* dhe një numër i vogël emrash të tjerë: a) këto *ilace*, *llafet* tona, ç janë këto *habere*?, kan ato *muhabetet* /, ka pasur *tarbjete* të mira /; b) n ato *çpillëzimet*; c) n ato *gjerde*, këto *kopshite*, male të larta *vënde* të bukura, n ato *vënde* etj.

§ 67 — Ndodh rrallë që emra mashkullorë, që e bëjnë shumësin me mbaresën -a dhe -ra, të ndërrojnë gjininë: ka tri *vreshta* të mëdha /, mirrij këto *mishra* /, *ujra* të thella.

§ 68 — Kur kundrina e drejtë është një përemër vetor i vetës së I ose të II, shpesh nuk përsëritet me trajtë të shkurtër. Ky fenomen ndihet edhe në Zagori dhe aty këtu edhe në të folme të tjera labe: mua gjete ti /, po të pieç mua /, ke mua ti /; ai ka gjar tia /, jesh vesh si kallogre për të puthur tia /.

§ 69 — Trajta e shkurtër e përemrit vetor veta e III rasi kallzore e në vetën e II shumë të mënyrës urdhërore vihet pas mbaresës e jo në mes saj dhe temës si ndodh në toskërishten e përbashkët: *hijnie* (< *hiqnie*), *merrie*, *bluanie*, *krrenie* etj.

§ 70. Karakteristike për të folmen / e Bregdetit të Poshtëm është përdorimi i trajtës së rrjedhore së shquar (si për gjininë mashkullore dhe për atë femërore) në vend të rrjedhore së pashquar në rastet kur tregon: a) çfarësi: *uj pusit*, *kulish ujkut*, *mish viçit*, nga *lëkur kecit*, *dru dubekut*, *raki rrushit*, *zavëz rripit*, ai ish *djal mbretit* /, është dit *parazit* /, një boj *njeriut*, haj se isht kos *fshatarit* /, si form *kanalit*, një far *barit*, deri në një far *vëndit*, e kam boj *hirit*; *mish deles*, far *qepës*, kok *cimarthës*, *kuti kafes*, jam marr me punra *shtëpis* /, (Si i thoni kësaj?) flet *penxheres*, lug *ndarjes* etj. b) kohë: vin në shkoll që për së *vogëlit* / u hodh për së *gjallit* /.

Siç duket edhe nga shembujt këtu nuk kemi të bëjmë me një gjindore të shquar, që ka humbur nyjën, po me një rrjedhore analogjike me trajtën e gjindores. Ky fenomen duket të jetë çfaqur më përpara në togfjalësi të tillë si: *mish viçi*, *uj pusi*, *djalë mbreti* etj. në analogji me *mishi viçit* (= *mishi i viçit*), *uji pusit*, *djali mbretit* etj., ku nyja e përparme nuk ndihet, dhe pastaj është përgjithësuar në tërë rastet e tjera.

Ky zëvendësim analogjik sot ndihet edhe në shumë: *gota rakive* (= *gota rakish*), *miza pemve*, *nome dhive*, *nome dhëne*, *shtrat rrobave* etj.

Janë të rralla rastet kur rrjedhorja e pashquar nuk zëvendësohet nga rrjedhorja e shquar: *bash rakie* (P.), *lëkur kau*, *mish derri* (N.)

§ 71 — Shpesh në Borsh parafjala më përdoret me emra të rasës kallzore për të treguar vend e kohë: a) u lëm pak *më kurris* /, dhe kthehet *më nome* /, portokalen e lë *më shtëpi* /, e hodhi *sevdan më një portokale* /; b) *zakonisht e ka më di or nat* /, të sulmon që *më dark* /.

§ 72 — Kallzuesit e formuar nga emra asnjans të shoqëruar nga pjesëza *një* shprehin veprime të shpejta.

Kur shërbejnë si dy kallzues të dy fjalive të bashkërenditura, tregojnë veprime që ndodhin fill njeri pas tjetrit, midis këtyre fjalive nuk ka pauzë dhe lidhen me lidhëzat bashkërenditëse *këpujore e, dhe*. Këto fjali: *kanë zakonisht kryefjalë e cila shprehet në përgjithësi në fjalinë e parë ç'bën ki? një të marr atë lëkurën dhe një të djeg /, një të par q e pa ki djali e një të bër një trëndafil njërit nga ata në xhep /.*

Këta mund të shërbejnë edhe si kallzues fjalish të pavarura dhe kryesore. Uhua e pa nga larg që ju bë trëndafil në xhep e *një të bërë zabit Uhua* /, atje tek flij kjo, *një të vajt* në huë ere portokalles q u doq. /.

§ 73. — *Fjali të varura kushtore*. Në këtë paragraf do të përmenden disa tipe fjalish kushtore, që janë karakteristike për këtë të folme e për një sërë të folmesh të tjera labe e çame²⁵). Materiali i pakët, që kam regjistruar, më lejon veç të bëj disa vërejtje të përcipta, po që paraqesin interes dialektor.

(25) Për të folmet çame kam parasysh të folnen e Mursisë sipas teksteve të mbledhura nga H. Pedersen e botuar në "Albanesische Texte mit Glossar".

a) Fjali të varura kushtore me lidhëzën *në qoft se*. Kjo lidhëzë, karakteristike sidomos për gjuhën e shkruar, përdoret jo rrallë në Borsh. Në Piqeras e kam dëgjuar vetëm një herë, ndërsa në Nivicë-Bubar asnjëherë. Për t'u vënë në dukje është korelacioni kohor i foljeve-kallzues. Këto fjali mund ta kenë foljen në të kryerën e thjeshtë (në gjuhën e shkruar ajo do të ishte në të tashmen), teksa fjalia kryesore e ka foljen në të tashmen: *në qoftë se s pati qumësht e jëma, e mën m atë tjetrën që ka pjell /, ulliri, në qoftë se e kreu lulen, s ka rezik /*.

Fjalia e varur mund ta ketë foljen edhe në të ardhmen e kryesorja në të tashmen: *në qoftë se ke për të thertur, e lë njëzet e pes ditësh dhe e ther /*.

Po të shprehë mohim, fjalia e varur kushtore me këtë lidhëz mund ta ketë foljen edhe në mënyrën lidhore: *në qoftë se të mo kish rar shi, do t e mjellëm arën /*.

b) Fjali të varura kushtore me lidhëzën *në mos që*. Fjalia kushtore e lidhur me këtë lidhëz tregon një veprim të mundshëm, folja kallzues e saj është në të tashmen e dëshërores, ndërsa e fjalisë kryesore në të ardhëshmen *në mos që na pënoft shiu, do të marr fun /*.

c) Fjalitë e varura kushtore të lidhura më lidhëzën *po* mund ta kenë foljen-kallzues edhe në të tashmen (në gjuhën e shkruar do të ishte në të kryerën e thjeshtë), teksa fjalia kryesore e ka në të tashmen: *po s ke alete, bën do luftë?*

e) Fjali të varura me lidhëzën *kurse*. Tregojnë kryesisht kusht, po në disa raste kushti gërshetohet me një nuancë kohe. Kuptimi kushtor-kohor dhe kushtor i këtyre fjalive ka ardhur nëpërmjet kuptimit kohor (konstrukte të tilla me kuptim kohor hasen më të rrallë në ndonjë të folme të shqipës). Kuptimin bashkërenditës kundërshtor, që kanë këto konstrukte në gjuhën e shkruar, nuk e kam ndeshur në asnjë shembull. Fjali të varura me lidhëzën *kurse* përdoren në Piqeras dhe Nivicë-Bubar.

Korelacioni kohor i foljeve-kallzues paraqitet si vijon:

Ajo e fjalisë së varur kushtore (ose kushtore kohore) mund të jetë në të tashmen e dëftores, ndërsa ajo e fjalisë kryesore në të tashmen e dëftores ose lidhore: bera *quhen* bagëtia, *kurse jan* të paka, *kurse jan* të shuma, *quhen kope /, kurse s ke ti që ke djalin me rrog* (për të bërë diçka — M.T.), *kush të bëj?*

Ajo e fjalisë së varur mund të jetë edhe në të tashmen e lidhore dhe e fjalisë kryesore në të tashmen e dëftores, e cila ka kuptimin e së ardhmes: *po, kurse të hapet rruga, je i dëndur me të mbathur me të veshur /*.

d) Fjali të varura me lidhëzën *posa*. Fjali të tilla tregojnë kryesisht kusht, po, si edhe në konstruktet me lidhëzën *kurse*, kushti gërshetohet me nuancën e kohës. Kuptimi kushtor-kohor dhe kushtor i këtyre konstrukteve ka ardhur nga ato me kuptim kohor, sigurisht nëpërmjet atyre me kuptim kohor-kushtor (konstrukte të tilla me kuptim kohor, nuk kam regjistruar). Fjali të varura të tilla me lidhëzën *posa* përdoren në Borsh dhe ndihen jo rrallë.

Korelacioni i foljeve-kallzues paraqitet si vijon:

Ato mund të jenë të dyja në të kryerën e thjeshtë: hajde, se, *posa re* këtu, *u bëre cop /, (të mos dalë — M.T.) se, posa dolli këtu, e fshiu era /*.

Ajo e fjalisë së varur mund të jetë në të kryerën e thjeshtë, dhe e fjalisë

kryesore në të tashmen: mos e shtrith, se, *posa e shtridhe, tharthet/; posa e shkuñe* nëpër shi, ashtu *bënet/*.

Folja-kallëzues e fjalisë së varur mund të jetë në të tashmen, ndërsa ajo e fjalisë kryesore në urdhërore ose në të tashmen e lidhore: *posa i ke ato* (mjetet e rrojes — M.T.), *rruaju* ati jasht/, *posa ka muñesi, ta ftom kañilen/*.

Folja-kallzues e fjalisë së varur mund të jetë edhe në të tashmen e lidhore dhe ajo e fjalisë kryesore në të ardhmen: ti merr er, se, *posa të mos marrësh er, do desësh/*, po, *posa të jet ajo e millur, ku do futet/*.

LEKSIKU

Baza dialektore e fjalorit të kësaj së folme është ajo e labërishtes. Për të ilustruar këtë po rendit më poshtë disa nga këto fjalë karakteristike: *cimbidh* (=mashë), *dej* (=pasnesër), *des* (=vdes), *dihem* (gdihem), *dhri* (=hardhi), *gab* (=shkabë, shqipe), *hej-a* (ushqim për kafshë), *kasdej* (më pasnesër), *kucur* (=kërcu), *nduk* (=çqyej), *mashan* (=kaci), *mbar* (=transportoj), *mëndroj* (nëmëroj), *prëhem* (=çlodhem), *sëllij* (=ha mën-gjez), *shkalem* (=shkelem prej hieve, shithem), *shterpoj* (=shteroj), *pretoj* (=bëj pre), *që-ri* (=qer) etj.

Nga sferat e ekonomisë terminologjinë më të pasur e kanë blegtoaria, frutikultura. Terminologjia e detit dhe e mjeteve të lundrimit është më e pasur në Piqeras e Lukovë, sepse në Bregdetin e Poshtëm vetëm këto fshatra janë marrë me peshkim e lundrim. Terminologjia e bujqësisë është relativisht më e pasur në Nivicë e Shënvasi.

Në lëmin e huazimeve vendin kryesor e zënë greqizmat. Këto janë më të shumta në Piqeras e Nivicë, po nuk mungojnë edhe në Borsh. Afërsia territoriale me fshatra minoritare greke dhe me vetë Greqinë, shpërnguljet në Korfuz të banorëve të Nivicës e Piqerasit, marrëdhëniet e ngushta ekonomike me Greqinë (Korfuzin), sidomos para pavarësisë, më në fund kisha dhe shkolla greke, këto kanë qenë faktorët që ndikuan në përhapjen e greqizmeve. Greqizma vërehen me shumë në sferën e detit dhe të mjeteve të lundrimit, në sferën e shtëpisë, bujqësisë e më pak në sferat e tjera. Greqizma vërehen edhe në sferën e marrëdhënieve intelektuale. Sfera më pak e prekur nga greqizmat është ajo e blegtorisë.

Sot këto greqizma kanë një karakter të kufizuar, ato përdoren më shumë në brezin e vjetër, po edhe tek këta një pjesë e greqizmeve përdoren për inercie, sepse, të ndërgjegjshëm për origjinën jo shqiptare të këtyre fjalëve ata i zëvendësojnë me fjalë të shqipes së përbashkët. Kështu tani përdoren më shumë: *pastroj* se *adhjas*, *lexoj* se *dhjajas*, *squfur* se *dhjaft*, *gjellë* se *fai*, *plagos* se *lavos*, *strehë* se *podhé*, *jastëk* se *proshqefall*, *fejoj* se *ravonjas*, *tel* se *sirm*, *fshesë* se *skupe*, *sheqer* se *zahar* etj.

Në brezin e mesëm dhe të ri të mësuar në shkolla shqipe përdorimi i greqizmeve është edhe më i kufizuar, sidomos i greqizmeve të sferës intelektuale.

Turqizmat zënë një vend më të vogël në numrin e huazimeve. Në Borsh ato janë më të shumta në krahasim me Piqerasin dhe Nivicën, po jo më të shpeshta se greqizmat.

Në terminologjinë e detit dhe të detarisë ka edhe italianizma si: *patël*, *sanpijero*, *tono*, *bandjer*, *floko*; *papafingo*, *trabakull* e ndonjë tjetër.²⁶⁾

26) Terminologjia e kësaj sfere përgjithësisht është e huajtur nga greqishtja dhe italishtja.

KONKLUZIONE

E folmja e Bregdetit të Poshtëm nuk është plotësisht unike. Ndryshimet midis së folmes së Piqerasit dhe të Nivicë-Bubarit s'janë të tilla që të vënë në dyshim karakterin unitar të atyre të folmeve; ndër to mund të përmendet kthimi i bashkëtingëllores dridhëse të gjatë *rr* në *r* në Piqeras. Midis këtyre vërehen dhe ndryshime në leksik, po këto i përkasin më tepër zhvillimit të terminologjisë së kësaj apo asaj sfere, gjë që varet nga drejtimi i ekonomisë së secilit fshat.

Ndryshime më të mëdha vërehen midis së folmes së Piqerasit dhe Nivicë-Bubarit nga një anë dhe së folmes së Borshit nga ana tjetër. Borshi duke mbetur i izoluar midis fshatrave të krishtere të Bregdetit, është afruar më tepër me fshatrat e Kurveleshit. Është kjo arsyeja që në të folmen e Borshit vërehen disa inovacione që janë karakteristike për të folmen e Kurveleshit. Ndryshimet i përkasin kryesisht fonetikës: a) Në B. grupet *mb, nd, ng, ngj*, janë asimiluar në *m, n, η, nj*, ndërsa ruhen mirë në P. e N.; b) Në B. bashkëtingëlloret e zëshme fundore (jo ato që janë bërë të tilla pasi ka rënë *ë* fundore) ose para bashkëtingëlloreve të shurdhëta kthehen në korespondueset e tyre të shurdhëta, në P. e N. ato ruhen kudo; c) Në B. bashkëtingëlloret *h* në fund të fjalës ndihet mirë, në P. e N. ose nuk ndihet, ose dihet mjaft dobët. Në B. nuk ndihet gjëkund tingulli frikativ mesgjuhor i shurdhët, që haset në disa fjalë si: *ah'ere, h'e* etj. në P. e N.; në B. këtij tingulli i përgjigjet tingulli *h*.

Në morfologji dallimet janë edhe më të vogla. Këtu mund të përmendet përdorimi i kufizuar në B. në krahasim me P. e N. i trajtës së vjetër të së ardhmes (kam+lidhore e tashme). Në B. kjo trajtë haset vetëm në foljen "them" p.sh. *ka të thot*, që në të vërtetë e ka humbur kuptimin e së ardhmes e është baraz me "do të thotë".

Ndonjë ndryshim vërehet edhe në leksik: *cimidhe* (B.) — *gërshërë* (N.), *shkurtoj* (B.) — *shurtoj* (N.), *krobur* (B.) — *kordh* (P.) — *koshere* (N.), *e mar* (B.) — *e marn* (P.) — *e man* (N.), *hamuriq* (B.) — *armoridh* (P.) — *ipi* (B.) — *mullar* (P.), *kabash* (B.) — *mastrapan* (P.), *ruz* (B.) — *sheleg* (P.) etj.

Siç shihet nga ky krahasim del që e folmja e Piqerasit dhe e Nivicë-Bubarit paraqitet më konservative se sa e folmja e Borshit, e cila nën ndikimin e së folmes së Kurveleshit ka shkuar më tej në disa pika.

Konservatorizmi i së folmes së P. e N. është rrjedhim i dy faktorëve: 1) Ashtu siç ka qenë i izoluar Borshi nga fshatrat e krishtera të Bregdetit, ashtu ato kanë qenë të izoluar nga fshatrat e tjera muslimane të Kurveleshit e Rrëzomës; 2) Bregdeti i poshtëm është zonë periferike dhe kufi me krahina çame, të folmet e të cilave kanë ndikuar reciprokisht mbi njera tjetrën.

M. Lambertzi në "Albanische Mundarten in Italien"²⁷), duke folur për të folmen e Vila Badessës, thotë: "Kjo gjuhë është një dialekt krejtësisht çam dhe është imediat fis me dialektet lokale të Bregdetit kundrejt Korfuzit, që i ka shënuar H. Pedersen në veprën e tij "Albanische Texte", po më shumë i afrohet dialektit lokal të Lëkurësit afër Sarandës qoftë nga format, qoftë nga tingujt".

M. Lambertzi me të drejtë e afron të folmen e Vila Badessës me të folmen e Lëkurësit, banorët e të cilit sipas H. Pederrenit²⁸) e kanë quajtur

27) Ludogermani, Jahrbuch II, 4.

28) H. Pedersen, *vep. e cituar*.

veten lebër, po pohimi se "Kjo gjuhë është një dialekt *krejtësisht* çam.." është i diskutueshëm, sepse të dhënat gjuhësore nuk flasin në favor të kësaj teze.

E folmja e Lëkurësit siç paraqitet në tekstet që sjell Pederseni²⁹⁾, nuk ka ndryshim nga e folmja e Piqerasit dhe e Nivicë-Bubarit, ajo paraqet, si të thuash, një etapë më të vjetër të së folmes së këtyre fshatrave, ku mungojnë grupet *kl* e *gl*, ku tingulli *l* i palatalizuar është kthyer në *j*.

Po përpiqem të vërtetoj që e folmja e Vila Badessës dhe e Lëkurësit nuk janë çame, sepse përndryshe duhet të pranojmë që e folmja e Bregdetit të Poshtëm është çame.

Është e vërtetë që në folme e Piqerasit dhe Nivicë-Bubarit ka disa tipare që e afrojnë me çamërishten, si: a) mosshurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund dhe në mes të fjalës para bashkëtingëlloreve të shurdhëta (edhe në Lëkurës ruhen), b) trajtat *çish* (=qish), *isht* (=është) si edhe c) ruajtja e togut *ie* në tri vetat e njëjësit të së kryerës së thjeshtë të foljeve të tilla si "liej", "thiej", etj. (në toskërishten e përbashkët dhe përgjithësisht në të folmet labe *ie*>e) : *lieva*, *tieva* etj., po këto të bien më pak në

vesh në krahasim me disa ndryshime të tjera, që janë më themelore, si: a) kthimi i tingullit të vjetër *l* të palatalizuar në *j*: *vaj*, *maj*, *goj*, *vrasi* *plasi* etj. (në çam. *val*, *malë*, *golë*, *vrasëlë*, *plasëlë* etj.); b) kthimi i grupev *kl* e *gl* në *q* e *gj*: *qumësht*, *qishë*, *gjëmb*, *gju* etj. (çam. *klumësht*, *klishë glëmb*, *glu* etj.); c) mospërdorimi për vetën e III njëjës të së pakryerës së dëftores veprare i trajtës *bënej*, *vinej*, që është karakteristike për çamërishten.

Pak a shumë në këto pika afrohet e largohet dhe e folmja e Lëkurësit nga çamërishtja e Mursisë. Ndryshimi që vëren M. Lambertzi midis këtyre dy të folmeve, është ndryshimi midis nëndialektit të labërishtes dhe atij të çamërishtes.

E folmja e Bregdetit të Poshtëm në bazë të tipareve të përgjithëshme fonetike e morfologjike bën pjesë në grupin e të folmeve labe, po feja e ka afruar më shumë Borshin në marrëdhëniet e tij me fshatrat e krahinës së Kurveleshit dhe si rezultat e folmja e tij nën ndikimin e së folmes së Kurveleshit ka pësuar disa inovacione që e vënë atë në një vend të veçantë midis të folmeve të tjera të Bregdetit të Poshtëm.

GLOSARI

Glosari përfshin një pjesë të fjalorit dialektor të kësaj së folme. Jam përpjekur të pasqyroj këtu sa më të plotë terminologjinë e blegtorisë dhe të detarisë (kafshët e detit, mjetet e lundrimit).

Nga sferat e tjera të jetës ekonomike e shpirtërore kam venë vetëm ato fjalë që më janë dukur karakteristike për këtë të folme, duke përjashtuar fjalët të cilat, megjithëse mund të kenë variante dialektore, janë më të përgjithëshme.

Fjalët në glosar janë renditur sipas rendit alfabetik. Bri fjalës është shënuar fshati ku është mbledhur fjala, nëqoftëse ajo përdoret vetëm në njërin prej tyre, ose nëqoftëse kam mundur ta mbledh vetëm në një fshat. Në fund, për të vënë në dukje pasurinë e terminologjisë blegtorale, kam renditur emrat e dhenve e të dhive sipas moshës, ngjyrës e brirëve.

A.

allonâr-i (<gr) — korriku.
ârdhës-i, shm. ~, it (B) — i ardhur: "mase ka ardhës, po ka pak fare".
ârdhje -a (N); "toka isht n ardhje për pun. — është në kushte të mira për t'u punuar.
arglë -ja, (<gr) — ulli i egër; *argëlidhe -ja* (B.).
arglo -i, shm. -nj (<gr-N.) — avëlmend.

B.

bacos, (B). — qëlloj me baca.
barb -a, (<gr — P.) — quhet vëllai i babait dhe i nënës.
bazot -i — gjysh.
bállës -i, shm. -a, t (P.) — kurrizi i dorës.
bandjër -a, (<it — P.) — flamur: "keshëm pezjet bandjera varka".
barben -i m. ~, ët (<gr—P) — peshk me mjekër dhe me mish mjaft të shijshëm (Mallus barbatus).
barkobëshite -ja, (P.) — varkë me vela, me tre direkë, që e përdornin për udhëtime të gjata.
bárdhe -ja (P.) — quhet dhia e bardhë.
barke -ja, (p.) — nënbarkez.
barx -a (<arum. N) — quhet dhia që e ka një pjesë të trupit kafe.
baskën (bie ~) — grabit: "z bie njeri barken."
bashogâbje -a, — quhet vela më e ulët e varkës.
baul -i, m. -et (N.) — sepet; në P. *baule -ja*.
beharore, mb.: moll ~ — lloj mollësh që piqen në verë.
bejk -a, — quhet delja e bardhë.
bëlb ndf. (P.): i çkuli dhëmbët që të flit *bëlb* / të mos flit mir//.
beléc -i, shm -ër, it (P.) — quhet qeni i bardhë.
belizm -a, — barishte e egër, rritet në tufa gjer në një metër.
berduvël -a, shm. -a (P.) — pllakë prej hekuri, që mbërthen derën në përvaz.
běj hall (P.) — gjej: "ajo vajza nashtin vate bën hall një kal të bardhë."
bërdhër -a (P.) — quhet lopa në ngjyrë të bardhë.
bëshudârdh mb: fik ~ (N.) — kokrra e fikut, që piqet më vonë se kokrrat e tjera të atij druri.
bie (i ~ frika) (P.) — zë frika, frikësohem: "dhe ati djalit i ra frika dhe një për një n shtri në krevat."
bigor -i — çukë me baltë të bardhë.
bün -a, shm. -at (P.) — derkuc, përdoret edhe *bic -i*, -ër.
birbil gjëmash (B.) — kryeartezë, gardalinë; në P *gadhel -i*.


bishtez -a (P.) — nënbishte.
bobël e fëlliqur (P.) — ligavec.
bobolishte -ja (P.) — shkarpë të holla shumë.
boçkël — boçkëla, shm. -a (B.) — 1) qepë deti; 2) dardh ~ — lloj dardhe kokërmadhe.
boçko mb. fik ~ (P.) — fik i papjekur.
bode -ja (B.) — shtambë, në N. *pode -ja*.
bodile -ja (N.) — shishe; në P. *butil -a*.
bonjâr -i, shm. ~, ët (N.) — jetim, bonjak.
boxhure -ja (B.) — arrë dhe çdo gjë tjetër bosh brenda; fig. budalla: "ai është boxhure nga mënjja."
bracol -i (P.) — sharrë e madhe për të çarë dërrasa.
bracjër -a — varkë e vogël me vela, me pjesën e përparme të drejtë.
braç -i, shm. -et (N.) — muskli i krahut.
bricimbidhe -ja (P.) — quhet dhia, brirët e së cilës në majë afrohen me njeri tjetrin.
bricjapé -ja (P.) — quhet dhia me brirë si të cjapit.
brihâl -a (P.) — quhet dhia me brirë të drejtë, të gjatë e të hollë.
brikërrut -i (P.) — quhet cjapi që i ka brirët të drejtuar nga mbrapa.
bubuzhin -a (P., B.) — zhuzhingë, vizhë.
budurâr -i (B.) — trung i trashë e i gjatë.
buc -a (N.) — quhet dhia e zezë me faqe kafe.
bujân -i (P.) — pellg që ushqehet me ujë e kroit.
burith -i, shm. -ër, it (<gr. — P.N.) — iriq.

Ç.

câkëz -a (P.) — thes i vogël.
cakule -ja (<gr. —P.) — qeskë.
capon -i, shm. ~; ët (N.) — shtat që ka pjesën e hekurit në formë katërkëndëshe.
cerrmi -u shm -nj (B.) — cinxami.
çfilidh -a (B.) — bërsitë e ullirit.
cimbidh -i (N., cimith — B.) — mashë.
çinçâr -i (B.) — ngatërrstar.
cirko -ua (B.) — cikofua, cikofa.
çjullëhem (B.) — prishem, dekompozohem (thuhet për mishin, peshkun dhe njerin e sëmurë etj.).
çklinjëm (B.) — qaj me ngashërim dhe heshtaz.
çkuliðhe — robra të lara e të shtrydhura, të vendosura njera mbi tjetrën.
çmir -a (P.) — quhet një lloj peshku si shirit me dhëmbë të mprehtë e të helmuar dhe me shumë hala.
çoqe -ia — trastë e vogël prej bezeje.
çplon -i (B.) — vendi, ku kalojnë natën bagëtia verës.
culi këmbës (N.) — fyeli i këmbës, kërci, ndërsa *cule -ja* — fyell.
çurk -u shm. çurqe (P.) — akrep, çfurk.
çurrufjasëm (<gr. — N.) — rrjedh nga mentë, matufepsem: "jam çurrufjasur n".

Ç.

çallti -a - çati.



a) kulmi shtëpis (P.B.); b) kumá -ja (P.); ç) Cimiðhe -ja (B), në N. gërs'hërëz -a; ç)prift -i, shm. -ër, d) kollon -a; dh) perastar -i, shm. ~, ët (<gr.); a) petrav -a, në B. bedrav -a.

çatore -ja (N.) - çadëre barinjsh.

çepë -ja - përçe, çërpe.

çiftë -ja (P.) - çifti i kutive, ku mbahet kafeja dhe sheqeri.

çiklore -ja (B.) - xixillojë.

çimithi ndj. (B.) - lojë fëmijësh; ndahen në dy grupe; çdo grup ngre nga tri rrasa në distancë rreth 5-6 m., pastaj secili grup me rradhë përpiqet të shkrojë rrasat e grupit kundërshtar për të fituar lojën.

çip -a - quhet dhia me veshë të vegjël. çiplllak ndf. (P.) - lakuriq; "mbeti çiplllak Piqerasi".

çitës -i, shm. -a (N.) - krebëri me dhëmbë të rrallë, që përdoret për të shqitur flokët.

çivom -a (P.) - boshllëku midis gurëve në një mur.

çivos (P.) - mbush çivomat me gurë të vegjël.

çkomolëps (B.) - pastroj diçka shumë të ndotur.

çkule -ja (B.) - shkull, çile.

çok -u (P.) - çekiq.

çokané -ja (P.) - zile e vogël, që u varet keçërve.

çuçgomar -i shm. -ët (N.) - quhet një lloj zogju me sqep të trashë; çinushkokgomar (B.).

çull -a - quhet delja me veshë të vegjël.

çumulliqe -ia (B.) - çerçem, caraca.

D.

dej ndf. - pasnesër.

derodash -i (fem. ~ e) (P.) - hermafrodit, në B. deredash.

diare -ja (P.) - zile e madhe, që ka një zile të vogël brenda.

dij - gdhij: "si u dive?", "u di sabau."

dimërore mb. moll ~ (B.) - lloj mollësh.

djepës -i shm. -e - fëmija që është ende në djep: "më prua mua djepse të rritur."

driktor -i shm. ~, ët (N.) - hauri ku rrinë dhitë dhe keçërit.

droke -ja (P.) - zile që u varet cjeppvë.

dru dubekut (N.) - filiç, ndërsa filiç i thonë pjesës së rumbullaktë të thurur, që përzjzen qumështin.

Dh.

dhihál -i shm ~, ët (<gr. - N.) - sfulk me dy dhëmbë për të mbajtur gjemba

dhri -a - hardhi.

dhromon -i; shm. ~, ët (<gr. - N.) - shoshë me vrima të një madhësie të ndryshme; që përdoret për të bërë shoshitjen e parë të grurit pasi e shijmë, ose të misërit; fig. vrima vrima: "mu bë dhromon tabárua."

dhrong -u, shm. dhrongje (P.) - peshk që ngjan me emirën, po ka më pak hala.

E. Ë.

egrom mb. fik ~ (B.) - lloj fiku i egër; kokrrat e të cilit edhe i thajnë.

élbij shm. -a, mb. dardh ~ (B.) - lloj dardhe kokërrvogël, që piqet në maj.

ëñërim -a (B.) - ëndër: "ai që pa ëñërimën", "thot që kam par një ëñërim."¹²

F.

fanëstër - fanestra (<it. - N.) - baxhë; në P. frangjidhe -ja,

faqëurrash -i (B) - kulaç në formë tre-këndëshi, që piqet në furrë mbi kongjij

fas -a (N.) - pëllumb i egër.

fashqá -ja (N.) - fashë që përdoret për të lidhur fëmijën.

fashqás ft. - lidh fëmijën me fashqa pasi ta kem mbështjellë me çarçafë e shpërgenj.

fir -a (e), shm. të firat (P.) - ija; në B. gofe -ja.

fishitk -u (B.) - shteg i ngushtë, ku njeriu mund të kalojë në gjunjë ose barkazi.

flamur -i (B.) - cipa e dhjamit, që mbështjell organet e barkut; rizë.

flloko -ua (<it. fiocco - P.) - quhet vela e mesit në pjesën e përparme, që ka formën e një trekëndëshi.

fol -i, shm. -e (<gr. - N.) = 1) furrik; 2) veza që vihet në furrik.

follók -u (B) - vend si fole, i mbyllur dhe i ngrohtë.

foti -a (<gr. - N.) - kandile.

franjgjidhe -ja (<gr. - P.) - baxhë.

frastua - frastoi, shm. -nj (P.N.) - mblatës.

frënjëz -a (B.) - quhet bishti i kokrrës së fikut.

frëth -i, shm. -e (P.), frënja (B.) - freri.

frukatëll -a (P.) - tel me dy degë për të mbajtur flokët.

frungulloj (P.) - përcëlloj: "m u frungulluan mustaqet".

fuck -a (B.) — lloj ëmbëlsire si tullumb.
fundrem (B.) — fundosem.
funose -ja (B.) — lakër e egër; buzëdelez.
fusik -u (N.) — lloj fiku i zi e kokërrmadh;
 të cilit i çabet lëkura kur piqet.
fusmi (B.) : "i ka hedhur fusmi kot"
 (plaga) — i është infektuar.

G.

gab -a, shm. *-a* — shkabë, shqipe; fig.
 u bë ~ — u plak shumë.
galic -a (N.) — gala.
garbun -i (B.) — lloj sëmundje; plasje.
gardhël -i, shm. ~, ët (P.) — kryeartëz.
gërthënj -a, shm. *-a* (P.) — gërthje deti,
 gafore.
gllënjëz -a (P.) — grethi .
gocar -i (B.) — gur i vogël i lëmuar.
gojë -ja (B.) — ije.
gojëz -a (P.) — sëmundje bagëtish, që i prek
 në gojë e mushkëri.
goxhivëre -ja (B.) — vrimë e madhe.
grihore -ja (N.) — këmishë burrash pa jakë.
guduvër -i (B.) — verore, verojkë.
gugurim -a (B.) — vend i pjerrët.

Gj.

gjerb ft. (<tr. — N.) — pi pak e nga pak
 diçka të lëngët: "gjerb një çik qumësht".
gjédhër (e) mb. kafsh ~ — kafshë e trashë
 (lopë, ka): "kam ca të gjedhëra e ca
 të kultëra."
gjes -a (N.) — quhet dhia e zezë e me bark
 të bardhë, që ka dy vija të bardha
 anës syve.
gjuaj ft. (N.) — mbledh, kërkoi: "u unj
 e gjuan ata grurët që t e gjen agai te
 porta.", "gjuaj lakra të buta nga të
 koshitit."
gjuh -a (P.) (solea solea) — peshk që vjen
 si i shtypur nga lart e poshtë, 15-20
 cm.
gjuhislër — *gjuhistra*, shm. *-a* (P.) — llafa-
 zane; B. *gjuhustër*.

H.

habër ft. (P.) — bëj haber: "habertin Tiranën".
handrësh -mb. fik ~ (N.) — lloj fiku i bardhë
 e kokërrmadh.
hamurig -i, shm. -ër, it (<gr. — B.) —
 urith; në P. *armoritë -i*.
harrohem (B.) — prishem menç: "u harrua
 plaku".
hëj -a (P.) — ushqim i mbledhur për kafshët.
hëlmëz -a (N.) — lemëza: "më zu helmëza."
hëlmëz -a (B.) — bimë bregdetare, që gjel-
 lëron gjithë vitin, me gjethe më të
 gjata e të holla se të dalinës; lëshon
 ca lule të bukura bojë trandafili, ndër-
 sa gjethen e ka të hidhur.

helmuar (i, e) mb. (N.) — i përzitur: "jo;
 se ishte helmuar."
hij pas (B.) — ndjek: "i nërsen qënin t'i
 hij pas."
hiris ft. (B.): "(qumështit) i heth far kosit
 dhe e hirisëm pas njëzetekatër orë."
 — trajzomë, hamë: "sa i hirisa një çik
 (kalemët për shartim) dhe i vura".
 — gërvishita.

hizmetoj (N.) — bëj hyzmet: "duhet të
 shpirti një nuse nënës, se nëna hizmeton
 vetëm".

hünralë -i (ja) (B.) — rrush i egër.

hünralësh mb. fik ~ (B) — lloj fiku i bardhë
 kokrra e të cilët lëshon rrëshirë nga
 fundi.

hurdhe -ja (P.) — urthi.

I. J.

ibrig -u (P.) — varkë me vela, me dy dirkë.

ipi -a (B.) — qipi; në P. *mullar -i*.

jamake -ja (N.) — enë bakëri ku ziejnë
 fasulet.

K.

kabash -i, shm; ~ ët (B.) — enë prej qelqi
 ose balte në formën e një qypi, me një
 verigë, për ujë; në P. *mastrapan*.

kaçk e gjurit (P.) — kupa e gjurit.

kafeç -i, shm. ~ , ët (N.) — xhezve; në
 P. *kukume*.

kalivar -i (N.) — 1) druri, në të cilin janë
 vendosur rrjesht vargjet me misër; 2)
 mënyra e varjes së vargjeve: "i vara
 misërat kalivar".

kallamátas mb. fik ~ (N.) — lloj fiku
 lëkurëtrashë për çepelë; në B. *kalla-
 mac*.

kalldis (<gr) — dobësohem, bie nga shëndeti,
 forca: "dhe Sokrati ka kalldisur."
 në B. *kalltis*: "pëna ime kalltisi."

kallziar -i, shm. ~, ët (P.) — spiu.
kanosjár -i, shm. ~, ët (P.) — beççi i
 fshehtë, që e emëronte dhe e njihte
 vetëm kryepleqësia e fshatit.

kanul -i, shm. ~ , ët (<gr. — P.) — pjesa
 mbi çati e oxhakut: "një shtëpi me
 pes kanul."

kapas -a (P.N.) — qyp i madh vaji, që nxë
 rreth 50 l.

karfos (<gr. — B.) — mbërthej, ngjit:
 "edhe balta mir e karfos mu si allçi."

karkaçe -ja (B.) — amfib që i ngjan bretkosës,
 po më e vogël se ajo, dhe që jeton nëpër
 pemë.

kasdëj ndf. — më pasnesër.

kasnjëditës ndf. — më pardeje.

katnác -a, shm. -a (P.) — hekuri që vihet
 prapa derës që ta mbajë të mbyllur.

kázij -a, shm. -a (P.B.) — lloj lakre e bardhë,
 që i ka gjethet jo dhe aq të ngjeshura

ken -a — quhet dhia bojë hiri.
këndçe -ja (B.) — tepsi e vogël, gjyveçe.
kërrut -a (P.) — quhet delja me brirë.
kiçar -i, shm. ~, ët (P.) — kërriq; dëgjohe
 edhe *pëllak -u*.
koç -a (N.) — gërsheta.
koç -a (P.) — quhet dhia me një bri.
koçkël -a (N.) — koçani i misërit; B. *koçkal*.
koj (B.) — mëkoj.
kohkafët -i, shm. — ër (N.) — zog që i ngjan
 harabelit, me kokë boje kafe.
kokoliçe ndf. (B.) — lëms, lesh e li: "jan
 hër kokoliçe."
kollër (i, e) mb. (P.) — që ka të bëjë me kuajt
 "erdh kafshët e kollëra."; "kam ca
 të gjedhëra e ca të kollëra"; miz ~
 — mizë kali.
kollçak -u, shm. ~, ët (N.) — kaptelli i
 pasëm i samarit; kokak.
kollovër -i, shm. ~, ët — dhëndëri që hyn
 në shtëpi të nuses.
londo (P.) — këmishë burrash me jakë.
kondrafllo -ua (<it. — P.) — quhet vela
 që ndodhet më në ballë të varkës.
kondrapapafingo -ua (<it. — P.) — quhet
 vela që ndodhet në majë të drekut
 të varkës.
konopice -a — marenë, kunopicë.
konjare -ja (E) — quhet dhia në ngjyrë të
 kuqe të mbyllur drejt kafesë.
korbe -i, shm. -ër, it. (P.) — quhet qeni i
 zi.
kordhon -i, shm. —, ët (P.) — 1) lidhëse
 këpuçsh; 2) tra i hollë katërkëndësh.
korrik -u — qershor.
koshun -i, shm. -e (N.) — nënbishtëz për
 kuajt me shalë.
kráhem (N.) — zibem për krahu: "një të
 hër zabit Uhua dhe u krahu me ta."
kráhi -a, shm. -a (N.) — rroba që mbështjell
 fëmijën kur e lidhin.
krëk -u (B.) : "i ka fjalët me krëk." — i
 ka fjalët të paka.
kripore -ja (N.) — kripësi.
kriqezár -i (P.) — rrypi që kalon mbi vithe
 të kalit.
króbur -i (B.) — zgjua; në N. *koshere -ja*;
 P. *kródh -a*.
kródh -a, shm. ~, ët (P.) — zgjua.
krósh -ja (P.) — dantellë.
ksart -i, shm. -e (<gr. — P.) — shkallët
 prej litari, me të cilat ngjitesh në
 shtyllat e varkës.
ksifios -i (<gr. — P.) (*Xiphias gladius*) —
 peshku shpatë.
ksq -i, shm. -e — kotec.
kshiel -i, shm. kshiej (P.) — lloj bari si
 radhiqe, që përdoret për sallatë.
kthénez -a (P.) — fik i bërë shumë, që varet
 kuac -a (<atum.) — quhet delja me fytyrë
 të kuqe.
kucur -i — kërcu.
kukujere (P.) — i thonë një grupe që mbetet
 pa njeri.
kulët -a, shm. -a (N.) — shilte e vogël për të
 ruajtur gjelperat.

kunj -a (<gr. — N.) — krevat fëmijësh;
 që thuhet.
kup -a, shm. -a (N.) — gotë balte me verigë
 anash.
kuqël, shm. kuqla, mb. dardh ~ (B.) —
 lloj dardhësh në ngjyrë të kuqe.
kutruve -ja (B) — katrovë prej balte.

L. Ll.

lakth -i (B.) — laku i kambës.
lar -a (m. -ush) — quhet dhia e larme.
lavos (<gr. N.) — plagos.
lëkostër -a (B.) — lëvezhgë; po në B. dëgjohe
 edhe *vlezhg -a*.
lëvroj (B.) — punoj leshin: "pastaj e lëvroj
 në krëhër."
lidh -a (N.) — tufë misërash të lidhur.
livër -i (P.) — ylber; në Hundecovë *vajzover*.
losták -u, *lostaqe* (B.) — thes i vogël, ku
 shtypnin ullinjë.
lugës -i, shm. ~, it. (N.) — lugë e madhe.
lutruvi -a (P.) — gurët me të cilët shtypin
 ullinjë, lëvizin me anë të kuajve; B.
litëri.
llabáne -ja — kapuç i gjatë prej leshi të dhirë;
 që e hedhin mbi kokë barinjët kur bie
 shi. Në B. edhe *bane -ja*.
llaj -a — quhet delja në ngjyrë të zezë.
llap -a — quhet delja dhe dhia me veshë
 të mëdhenj.
llamuc -i (B.) — batak.
llapác -i (B.) — vegël për të prashitur në
 formën e shatës, po më e madhe.
llër -a (P.) — parvazi i dyerve.
llomie -ja (B.) — zhavorr; fig. copë copë
 e ka thier këmën, e ka hër llomie."
llóvër -i (P.) — varkë me vela më e madhe
 se braçjera.

M.

maç detit (P.) (*Scyllorhinus cumcula*) — peshk
 me një erë karakteristike; micë deti.
man (e) (N.) — e martë; në P. *e mam*, ndërsa
 në B. *e mar*.
margalé -ja (<gr. — P.) ; në B. *bajame*.
marhamën -i, shm. ~, ët (<tr. — B.) =
 peshqir.
mashán -i, shm. ~, ët — kaci.
matrak -u, shm. ~, ët (P.) — hekur i gjatë,
 i kthyer në majë, që përdoret për të
 hapur e mblëdhur prushin në **furrë**
mazgáll -a (B.) — vrimë e madhe në mur
 ose në ndonjë send tjetër.
mazh -a — quhet delja me faqe të zeza.
mbërthekj -a, shm. -a (P.) — mbërthekë
 mashkull e femër.
mbillasimazi ndf. (P.) — lojë fëmijësh;
 s; mbyllazi.
mblat -a, shm. ~, ët (N.) — meshë.
mbresh -a (P.) — gardhi prej shkarpash e
 gjemshash, që rrethon vendin, ku flenë
 bagëtia.
mellanur -i (P.) — (Oblada *mellanura*)
 lloj peshku; melanura.

meridhe -ja (P.) — lloj peshku më i vogël se sardelja.

mesit -i (P.) — mbles.

metstar -i, shm. ~, ët (P.) — një i tretë, që ndërmjetëson për të pajtuar dy të tjerë.

mesuar - *mesori* (B.) — ledhi që ndan dy ara.

metabashk ndf. — me vrap, më të katra: "ecën metabashk.", "e ndoqi metabashk."

metaksh -i (B.) — mëndafsh.

mëllënj -a, (m. -ash) — quhet dhia e zezë.

mëmzonj -a — gjyshe.

mëndak -u (P.) — mëndarak.

mëndër - *mëndra* (P.) — stivë drush.

mëndroj (P.) — nëmëroj.

mëzák -u shm. -ër (f. mushjtjer) (P.) — quhet demë dhe lopa nga 1 deri 2 vjeç në N. *mëzuar*.

mëzuar - *mëzori* shm. *mëzor*, ët (f. -e) (P.) — viçi nga 6 deri 12 muaj.

mirëkëshillazi mdf. (N.) — në mirëkuptim "ju i liri mirëkëshillazi".

mjëkërz -a (N.) — mustaqet e misërit.

mjet -a (B.) — filli tërthor, që e mbush pëllhurën së gjeri; ind; filli tjetër quhet *maj-a*.

mo pj. moh. (P.) — mos: "të mo flit mir" "mo e vra i thot kjo vajza".

murgo-ua (f. *murr* -a) (P.) — quhet qeni i murmë.

muzg -a (B.) — pyll makjesh shumë i dendur, ku drita depërton pak.

N.

nëjth -i (P.) — kyçi i këmbës.

neqëz -i, shm. ~, ët (P.), përdoret edhe *cingun* — dorështrënguar.

nëspull -a, shm. -a (B.) — mushmullë.

ngaloj fint. (P.) — hipi mbi kafshë: "ja ngalova gomarit"; ant. *çkaloj*.

ngon -i, shm. -ër, (f. -e) (< gr. — N.) = quhet fëmija i fëmijës, ndërsa fëmija i vëllait quhet *nip* (f. *mbes*).

ngre (P.): "u ormisi mbreti që t e mir, ngriti dasmën" — zuri dasmën; "i ngre në kadhro" — nxjerr fotografi.

nxën (e) mb. (N.) — me barrë: "jesh e nxën; mezi jemi vartur".

qallohet (B.) — trashet e prishet bari: "pa u qalluar bari, do vem në mal".

qrale ndf. (B.) — ngritur: "veshët qrale duhen majt."

P.

pagán -a (B.) — grupi i gjuetarëve që zbulojnë kafshët e egëra dhe ua drejtojnë në pritë gjuetarëve të tjerë.

pakár -i, shm. ~ ët (P.) — bariu me pak bagëti.

paláne -ja (N.) — kaci e madhe prej dërrase, me të cilën hedhin bukët në furrë; quhet edhe *që-ri*.


palcár -i (B.) — kalli misëri i njomë.

pallamidh -i (< gr. — P.) — lloj peshku me mish të majmë e të shijshëm.

papafingo -ua (< it. *pappafico*) (P.) — vela e mezit e varkës.

paparun -a (< gr.) — lulluq.

parmënd -a (N).



1 — *tevlík* -u, shm. *tevlíqe*; 2 — *xgjedh* -a; 3 — *puqídh* -a (< gr.); 4 — *sirt* -i, shm. -ër; 5 — *spath* -i, shm. -ër (< gr.); 6 — *plor* -i; 7 — *tártar* -i, shm. -e; 8 — *këmb* -a; 9 — *h'íroluth* -a (< gr.).

pastanáke -ja (P.) (*Trygon pastinaca*) — lloj peshku që i ngjan rajës; bisht miu.

pátël -a (< it. *patella*) (P.) — molusk i vogël, që ngjitet nëpër shkëmbinjt.

patíqe -ia (B.) — pantofël.

pelár -i, shm. ~, ët (N.) — çoban kuajsh.

perdhúkul (< gr. N.) mb. fik ~ — lloj fiku kokërrvogël, që thahet.

perveg -a (B.) — rryp lesi për të lidhur fëmijën në djep.

peshllí -u, shm. -nj — një lloj këmishe me mëngë të çara prej sqetullës deri te bërrylet, që zakonisht i hedhin prapa.

peshqësh ft. (N.) — bëj, jap peshqesh: "ven pastaj dhjet burra që të peshqeshën nusen".

pëgátém (B.) — shastisem: "kur qe i vogël ish djali i hedhur, po tani sepse u pëgat.

përcëlloj (P.) — fshikëlloj: "më përcëlloi me shufër."

përpárij -a, shm. -a (P.) — përparëse, futë.

pihem (N.) — tretem, dobësohem: "na u pi djali."

píkløj (P.) — spërkat.

píllhi ndj. (B.) — lojë fëmijësh; cingëlthi.

pin -a (< gr. — P.) — molusk.

pipitem (B.) — thahem për ujë.

pixmos (fr. (B.) — zëmëroj; nevrikos.

plakosém (P., N.) — fshihem; "u plakos e nuk shihesh."

plashuze -ja (B.) — fatkeqësi.

plísé -ja (P.) — veshje grarishte, fund me kinda.

pllakatore -ja (B.) — rrasë e hollë, e lëmuar; që gjëndet në lumë ose det.

pllock -a (N., B.) — dry, kyçenicë; në P. *pllockar* -i.

pllungo -ua (P.) — pemë e pjekur tepër; fice: "isht bër pllungo."

poçar -i, shm. ~, ët (P.) — enë për të pirë ujë; tas.

pogon -i, shm. -e (< gr. — B.) — saç.

pollk -a shm. -a (P., N.) — bluzë grash, që vishet me fund.

pori -u (B.) — gur poroz.

portopull -a, shm. -a (P.) — derë e vogël; derickë.

pos -i, shm. -e (B.) — lëkurë deleje për të ndenjur; postje.

poshtovani -i, shm. ~, ët (N.) — parvazi i dyerve.

potis (< gr.) — vadit.

pretoj (P.) — bie në pre, bëj plaçkë: "vijën e pretoin."

protogjeni -i, shm. ~, ët (f. -e) (< gr.) — quhet çjapi dhe dhia një herë pjellë.

pshal -i, sh. *pshenj* (N.) — mëz.

pull -a (B.) — misëroke (mashk. *kapua*).

pullak -u, shm. ~, ët (f. -e) (N.) — quhet gomari nga 1 vjeç e lart.

punëse mb. (B.), ara ~ — ara që punohen.

puntori tokës (B.) — dosëza, bushtërza.

Q.

qelq -i, shm. -et (N.) — gotë uji a pije; në P. *qelqe -ia*: "nam një qelqe raqi".

qëpës - qëpsi; shm. ~, it. (N.) — rroba-qëpës.

qers -a (< gr. — P., B.) — lëndinë; në N. *h'ers -a*.

qilistër-qilistra, shm. -a (<gr. P.) — hoje; në N. *pite -ja*.

qinos ftr. (P.) — ja jap bagëtinë një tjetri për t'i ruajtur në bazë të një pagese: "i kam qinosur bakëtin".

qipër-qipra (P.) — zile shumë e madhe, me peshë deri dy kg. për deshtë ose cjeptë përcorë.

qirith-i (P.) — shkurre me degët si të shelqjeve lotonjës, që rritet nëpër shkëmbinj; gjunjës.

qullash -i (B.) — lloj byreku me lakra e oriz.

qulle-ja (N.) — bukë misëri e ardhur.

R. Rr.

räh'e -ia (< gr. — P.) — breg.

rëm-a (B.) — rërë, (në Përmet: rëmë).

rij ftr. (N.) — hyj "dhe rin brënda te gruaja".

rin-a (< gr. — P.) — një lloj peshku i madh deri 200 kg.

rokani -i (< gr. — P.) — zdrukth.

rokanidhe -ja (B.) — shiritat e hollë të drurit, që dalin nga zdrukthi.

rokanis — zdrugas; fig. lodh; çaj kokë: "ik mos më rokanis."

roqet -a (P.) — veshje grash fund pa kinda.

ruz -a, shm. -a (B.) — quhet qengji 6-12 muajsh; në P. *sheleg -u*.

rrieth -i, shm. -ër — skifter.

rrojrrrotull ndf. (N.) — rreth e rrotull: "ja atje rrojrrrotull isht."

rroshje -a (N.) — mëllënjë në ngjyrën e tymit e me sqep të zi.

rrushkalë -a (B.) — hardhi e egër.

rrushkuqe -ia (B.) — vilja me burbuqe e lofatës

S.

saizëm-saizma (N.) — rroba që mbulon minderin.

sakavë -ja (N.) — xhaketi; thuhet edhe *taburo -ua*.

sânëll-a, shm. -a (B.) — opinga me gomë të trashë makine dhe mbi të me meshinë.

sanpjëro -ua (<it.— P.) (Zeus faber) — peshku kovaç.

sëndua—sëndoi, shm. -nj. (< gr. — P.) — çarçaf; në N. *sëndon -i*.

sëlli -a — ushqimi i mëngjezit, mëngjezi: "nuk ha dot sëlli."

sëllib -a (P.) — nevojë e madhe e brendëshme për të fjetur: "llë sikur ke sëllibën."

"të ka rir sëlliba në si". "ngreu t'ikij sëlliba." MEYER (Etymologisches Wörterbuch der Alb. schp., fq. 382 jep

kuptimin Schlagsucht, si fjalë kalabrese.

sëllij — ha mëngjes: "dua të sëllij."

sëmërij -a, shm. -at — shemër: "pse hai si di sëmërija."

sikuqe -ia (P.) — quhet delja që ka rrotull syrit një rreth të kuq.

sisk -a — quhet delja e bardhë me dy vilarë të zes në faqe, që i varen si lotë.

sizéz -a (P.) — quhet delja që ka rrotull syve një rreth të zi.

shkalistir -i (< gr. N.) — çapë.

skanaj -a, shm. -at (P.) — karrige; në N. *skanjo -ua*.

skot -i (N.) — errësirë.

sorua — soroi, shm. -nj. (< gr. — P.) — grumbull i parregulluar sendesh.

spáro -ua (P.) (Sargus annullaris.) — lloj peshku i vogël.

splithar -i (B.) — zgavër në trungje, që mbushet me ujë gjatë shirave dhe e ruan atë për një kohë.

spurith -i, shm. -ër, it (N.) — harabeli.

sqepverdhe -ja (N.) — mëllënja me sqep të verdhë.

sqillopsar -i (< gr. — P.) — peshkaqen.

supé -ja (P.) — kafshë deti, që i ngjan tetëkëmbëshit.

surdís (N.) — degdis: "do na surdisën në një vënd."

Sh.

shapkát -i (B.) — lloj byreku me lakra.

shargán -i (P.) — tufa e leshit, që u lënë dheneve në kurris kur i qethin: "i qetha me shargan."; në B. *shargane-ja*.

sheprák -u, shm. - ët — derëmbyllur, fat-keq.
shëmëhill -i — nëndori.
shëmítër- shëmítiri — tetori; në P. shimitri.
shënëndre -u — dhjetori.
shërr -a (B.) — sharrë.
shit -a quhet dhia pa brirë.
shkålem (B.) — shkelem prej hieve, shito-hem: "nuk del (lehona), se shkalet."
shklebua — *shkleboi* shm. -j (B.) — shalqi i vogël i pabërë
shkumåre -ja (B.) — guackë deti, që del anës.
sholl -a, shm. -a (B.) — këpuçë sholli me xhufkë në majë.
shpejms (e) (i.e) (B.) — i vjetër: "do të blej fjal të shpejsme, të lashtësme."
shterpuar — *shterpori*, shm. shterpor, ët (f. -e) — quhet çjapi dhe dhia dy herë pjellë.
shtënur (i, e) (B.) — i vëngër.
shtërpådih -a (P.): i jap ~ ën — i jap dërmën, i vë fshesën.
shtipës -i, shm. ~ , it (B.) — bishti i havanit.
shtrapos (N.) — ngjesh: "na shtrapose a i zi, po ik një çik më tutje."
shuhëz -a (B.) — gomë për të fshirë.
shujtoj (N.) — i jap të hajë, ushqej një tjetër: "kush e shujton këtë?"
shur -i (B.) — zhur, zhavor, në P. i thonë edhe rërës; fig. "di ~ in e detit" (N.) — di shumë.
shurtoj (N.) — shartoj; në B. *shkurtoj* "shkurtova një gorric, e bëra dardh."

T. Th.

tabåke -ja (<tr — B.) — pjatë.
tabaqere -ja (B.) — pasqyrë.
tabåro -ua (P.,N.) — xhakëtë.
tellåro -ua — kornizë ku vihen hojet.
temperin -i (< it. — P.) — brisk xhepi, sojak.
tërkuil -i, shm ~ , ët (N.) — cfurk me tre dhëmbë për të hedhur grurët në erë, trikul.
timës — *timsi* (B.) — vegël që përdoret për t'u hedhur tym bletëve.
tirk -u, shm. tirq, it — kallce të bardha.
tono -ua (<it. — P.) (Thunarus thynnus) — lloj peshku; toni.
trabåkull -i, shm. trabakuj (< it. trabåcolo) — varkë e vogël me vela, që e ka pjesën e përparme të kthyer lart.
trapi -a (B.) — qilizmë: "i kam bër arat trapi."

trapis (B.) — hap qilizmë.
truhm -a (B.) — ciklon që vjen nga deti.
tunbishtez -a (B.) — bishtundës.
theri -a (P.) (Atherina hepsetus) — lloj peshku; terina.

U. V.

u -ja (P.); në B. edhe *uri* — *uria*.
ujëmure -ja (B.) — burim.
ulëråk -u, shm. ~ , ët (P.) — ai që ulërin.
urith -i, shm. -at (B.) — iriq.
vak -a (P.) — quhet delja me fytyrë bojë kafe.
varg -u shm. vërgjënj (N.) — quhet dashi që mbahet për damaz.
varrë -ja (B.) — vend me gurë, gurishte: "pse në varre më caktuat mua, atje z bëhet as rigoni."
varris (N.) — lesoj; në B. *branis*.
verdh -a (m. - ush) (P.) — quhet dhia me ngjyrë si të kuqe.
vest -a (N.) — fustan.
veshtull -a (B.) — gjarpër ngjyrë kafe, që sheh vetëm në errësirë, më i vogël se bullari dhe me helm.
vetul -i, shm. vetujt (N.) — quhet keci nga 6-12 muaj.
vëlçës -i (B.) — këlbazë.
vërvåt -i (B.) — kalë i patredhur.
vjeshit -a — shtatori.
vjeshitåke mb. dardh ~ (B.) — lloj dardhe që piqet në shtator.
vråka em. shm. — pantallona leshi, të cilat prej gjuri e poshtë ngjiten pas këmbës.
vrizh -a (N.) — quhet dhia në ngjyrë kafe të hapur.

X. Z. Zh.

xbeg -u — sëmundje bagëtish, zbecth.
xjëbez -a (P.) — barishte e egër, në gjeten e së cilës dalin disa kokërrza të vogëla si pugnra.
xbërdhuqur (i, e) (B.) — i zbardhur.
xol -i, shm. -e (B) = plis.
xhuf -a (N.) — pjesa e bimës së misërit nga kalliri e lart; maja e misërit.
zaqna - *zaqoi*, shm. -jt (B.) — copë toke e hapur në një vend të pjerrët, e rrethuar me mur nga ana e poshtëme.
zeb -a (m. — ash) — quhet dhia e zezë me vija të bardha.
zhërm -a (B.) — llucë: "mezithi dolla nga zhërma."; dëgjohej edhe *luc -a*.
zhin -a (N.) — zagushi: "ka zhin sod."

Emërtimi i bagëtisë

Këtu poshtë po rendit emërtimet e bagëtisë sipas moshës, ngjyrës, brirëve e shenjash të tjera. Do të ve edhe disa fjalë të tjera të sferës së blegtorisë. Renditja e fjalëve jo gjithënjë do të ketë për bazë rendin alfabetik.

Për të kuptuar emrat e bagëtive është e nevojshme të sqarohen disa gjëra: a) Në kompozitat bal + një emër tjetër komponentja e parë tregon që dhia ose delja ka një vulë të bardhë në ballë, ndërsa komponentja e dytë tregon ngjyrën e trupit. b) Komponentet e dyta të kompozitave ken+ një emër tjetër përcaktojnë nuancën e ngjyrës së hirtë. c) Lar quhet dhia që vende vende është e zezë, po në kompozitat lar+emër tjetër, komponentja e dytë tregon ngjyrën kryesore të dhisë, ndërsa emri lar jep idenë që ajo dhi vend-vende është e bardhë, ose përshkohet nga një rrip i bardhë në mes. ç) Emrat: briciape, koç, shit, llap, gull që emërtojnë dhitë ose dhentë sipas brirëve dhe veshëve, formojnë kompozita duke u bashkuar me emrat e dhive ose dhenve sipas ngjyrës.

Emërtimi i dhive:

a) sipas moshës

keç -i, f. -e — nga lindja deri 6 muaj.
ftuj -a, m. -ak — 6-12 muaj; N. vetul -i, f. -e.
portojen -i, f. -e — 1-2 vjeç.
shterpor -i, f. -e — 2-3 vjeç.
cjap -i, f. dhi -a — 3 vjeç e lart.
tresh, f. -e, katshe etj. mb. dhi ~, që
ka pjellë tri herë.

b) sipas ngjyrës

balken -i, m. -ash
balmëllënj -a, m. -ash
balzeb -a, m. -ash
balzebken -a, m. -ash
bardhe -ja, m. -ash
barx -a (N.)
buc -a (N.)
gjes -a (N.)
ken -a, m. -ash
kenmug -a
kenpëllumbe -ja
kokken -a, m. -ash
kokverdh -a, m. -ash
kokzeb -a, m. -ash
konjare -ja (B.)
lar -a, m. -ush
larmëllënj -a, m. -ush;
në N. edhe larbrezare -ja
larmushk -a, m. -al (N.)
larverdh -a, m. -ush
larzeb -a, m. -ash
mëllënj -a, m. -ash
verdh -a, m. -ush
vriz -a (N.)
zeb -a, m. -ash
zebken -a, m. -ash

c) sipas brirëve

bricimbridhe -ja
briciape -ja
bardhbriciape -ja
kenbriciape -ja
larbriciape -ja
mëllënjbriciape -ja etj.

brihal -a

brikërrut -i

koç -a

koçken -a
koçlar -a
koçmëllënj -a
koçzebken -a
bardhekoç -a etj.

shit -a

shitbalzeb -a
shitbardhe -ja
shitlar -a
shitken -a
shitmëllënj -a etj.

ç) sipas veshëve

çip -a

llap -a

llapbalzeb -a, m. -ash
llapbardhe -ja
llapken -a
llapmëllënj -a
llapzeb -a
llapzebken -a etj.

* * *

përç -i

shm. -ër

Emërtimet e dhenve:

a) sipas moshës.

gënjgj -i, f. -e = nga lindja deri në 6 muaj
sheleg -u, f. -e — 6-12 muaj; në B. ruza,
milor -i, f. -e — 1-2 vjeç.
dash -i, f. dele — 2 vjeç e lart.
tresh, f. -e, katshe etj.

b) sipas ngjyrës

bejk -a

kuac -a

llaj -a

mazh -a

<i>sikuqe -ia</i>		c) sipas veshëve
<i>sisk -a</i>		
balsisk -a		
<i>sizez -a</i>	<i>çull -a</i>	çullbejk -a
<i>vak -a</i>		çullllaj -a
		çullkuac -a
		çullsisk -a
c) sipas brirëve		* * *
<i>kërrut -a</i>	<i>varg -u</i>	
krrutbejk -a	<i>mëndak -u</i>	
krrutellaj -a		* * *
krrutemazh -a	<i>bravare</i>	
<i>hit -i</i>	<i>cangadhe -ja</i>	

—1—

Qe një bij e priftit / dhe një i bir i mbretit // të bijën e priftit e thoshin Penamurfi / se ajo ziet filli gjithnjë // ata po penxheret i kishin të afërta dhe e shih shoshoqin kurdo // po ajo e bij e priftit nuk e ip veten / e mbaj më lart se i biri mbretit // thosh se s e bëj për ka-bull // po ai djali mbretit e duaj me gjith shpirt / kjo nuk e beson //

ajo vajza po vin në shkoll gjithnjë / dil nga shkolla e vin vadit vasilikon¹⁾ // e i flit (ai): sa dega të ka vasilikoi / Penamurfi?

— sa lira të ka korona / i thosh kjo //

— thuj aman / sa të kostis²⁾ ai vasilikoi?

— sa të kostis korona jote / i thosh kjo //

— thuj / moj Penamurfi / se u do të mar / nuk të qesh / po thujm sa të kostis ai vasilikoi it?

— sa të kostis korona jote //

ikën ajo vajza vete te zonjushja / i thot zonjushes : më ka rar përsipër djali mbretit e më thot: "sa dega ka vasilikoi?" dhe u i thom që sa të ka korona jote / se u jam frir me inat / se ai nuk më merr / se ai ishte djali mbretit //

i përgjigjet zonjushja e i thot që / kur ka kaq mani të madhe / mos ja prish qefin / se do të të mar //

djali mbretit nga mania që kish / u vesh si bollgre / mori dhe kondisma ndë dor / dhe vate në shkoll tek ajo vajza // edhe u ngen / proshqinisën³⁾ në kondism nxënësit e shkollës // u ngre dhe kjo vajza me zonjushen / proshqinisën ndë kondism // pastaj u ngre dhe ai djali dhe puthi atë vajzën / edhe iku vate në shtëpi / edhe rij në penxhere / ati prit këtë vajzën të dil nga shkolla // dolli ajo vajza e vate të potis vasilikon / t i hidh uj vasilikoit // i thot djali: sa dega të ka vasilikoi / Penamurfi?

— të kam thënë një her / i thosh kjo / sa lira ka korona jote //

— thuj Penamurfi / se do të të mar / s të lë pa mar!

— do më març të keqen!

— qe të mir ata të puthur që të dhash në shkoll? u jesh / jesh vesh si kallogre për të puthur / moj Penamurfi //

ngriet kjo vajza vete te zonjushja // — e she / zonjushes / që qe djali mbretit ai që më puthi mua?

— po e she / i tha zonjushja / të thash që do të marr / nuk të lë // ajo vajza u nxe shum // edhe iku me inat dhe vate në shtëpi / dhe mejtonej sh t'i bën djalit e mbretit // ajo vajza nashtin vete bën hall një kal të bardh // bënë me mjekër të bardh / edhe këllçin vartur / me thik // ja hipën kalit dhe vete te mbreti // dolli roja dhe e ndalon // — shtëmëng / se jam Shëmehilli që do vete të marr shpirtin e djalit e mbretit!

me të çpejt vete roja te mbreti / dhe i thot: këtu këtu puna // po sa të suguronej roja / vate kjo vajza te djali mbretit // kur e pan / u çudin / dhe ati djalit i ra frika dhe një për një u shtri në krevat // ju kthie mbreti me rixha të madhe / i thot: — aman se e kam të vetëm nashti nga rixhat e mbretit q i bëri / që t i lij shpirtin djalit / i prishi surat / i prishi b kurin / i çkuli dhëmbët që të flit belb / të mo flit mir / që të kren inan e saj // dhe ikë / vajza vete në shtëpi // vete dhe te zonjushja dhe i thot zonjushes q e mora hakën time / kështu e kështu i bëra //

— ç bëre / o kallogre / ai do të mar nashti / do krey inatin //

djali u shërua dhe dolli prap në penxhere / edhe prit Penamurfin të dil nga shkolla // doll-

1) Lloj luleje. 2) koston, vlen. 3) u falën.

dhe Penamurfi dhe potis vasilikon // po djali nashti flit belb / i thot: — sa sa dega të ka vasilikoi Pepenamurfi?

— sa sa lira të ka korona / more / dhe qesh me të //

— qe qe të mir ata të puthur që të putha?

— po ata dhëmbët që të çkula e të bëra belb / qe të mir?

— e ti ti ti më ke bër mua kshu ? po u do të të mar tia / moj Penamurfi / e zu e qau

— ti më do / po u s të dua //

u ngre ki djali tuke qar // vate tek i jati // i thot të jati: — ti / baba / kur të thash u për Penamurfin / nuk deshe t e marje // ajo më ka bër kshu / se u e putha në shkoll / dhe ajo u kthie / u bë si Shëmehilli e më pru në këtë gjëndij // e u Penamurfin do t e mar / e dua //

edhe mbreti u ngre vate te pristi / e kërkon Penamurfin / edhe e ravonjasi¹⁾ /

u ngre Penamurfi / vete tek ustai që bën kukulla // i thot: — të më bëç një kukull si dhe u / edhe t i nga një sust / t ecij / edhe t e zëç këtu / t ja bëj me temena si nuset që ja bëjën //

ja pregaditi ustai si i tha //

u ormis mbreti që t e mirr / ngriti dasmën // mirpo Penamurfi ormissi kukullën / e bëri nuse edhe e mori prej dore e van te mbreti // si mbaroi darka që mbaroi / që do viin të flërin / që të bjerin në jatak / vuri kukullën në jatak dhe ftoi dritën / dhe bëri sikur dolli / dhe u fut nën krevat të tyre //

djali mbretit i thosh: — a moj Penamurfi / pse të m i bëje këto? u do të të marij / nuk të lërij / po ti jesh e pabes tek u //

kjo vajza i ngit sustën me dor / dhe ja bën me kok djalit kukulla në shtrat //

ki i thosh: — akoma do më pëlcaç nga inati? e shtrëngoi shumë kukullën / po ai kukullën e quan Penamurfin / edhe një të mar thikën dhe ja nguli në grik // si e theri / ju derdh rozholi²⁾ dhe ai i pij gjakun // piu sa u ngop nga ai rozholi kuq / edhe ju çkre vaj // qaj / dhe morikoburen / edhe vate të vrit veten //

— mo e vra i thot kjo vajza / se ja tuk e ke Penamurfin // inatin e nxore te kukulla / se Penamurfin ja tuk e ke

E tregoi Ollga Llaçi,
Piqeras.

—2—

U zu një burr me një grua //

i thot gruaja: rri se do të lidh / i thot gruaja //

— ik / mor djall / ti do të më lidhç mua //

si shkuan tre katër dit / van në mal të mbill misër // kjo shkon / blen tre katër pishq / dhe ati ku do hidh koqen e misërit / i hidhte nga një pishk në vij // kur ktheej burri / shij dhe i mirr / dhe i thosh: — grua gjeç një pishk / na //

ashtu ja bën njëjera sa ja hodhi të katër //

dhe ki ja dha / dhe ik / i thot / na i bëj për dark //

vate gruaja në shtëpi / dhe i bën një tjetër fai. // kur i vuri bukën për të ngrën / që i vuri bukën të baj / nuk i shpuri pishqit / po i shpu tjetër gjell //

ahere i thot: pse s gatove pishqit?

— ç pishq? i thot / ku t i marr? i thot //

— ata që gjeta në ar ku punoja //

— ka pishq ara? i thot ajo / je në vete apo u marrose?

— si s ka? u i zura me dor time //

— jo / i thot / s je në vete / u marrose / i thot //

ki ngriet dhe i jep një bac // kjo vuri ulurimën / dhe u mblodh gjithënia //

— ç ke? i thon //

— m u marros burri //

— çish u marros?

— më thot / pse s gatove pishqit që zum n ar //

— isht e vërtet që ti ke zën pishq n ar?

— i kam zën / thot / me dorën time //

dhe kshu u lidh mavria burr //

E tregoi Ndreko Cuni,
Piqeras

1) e jejoj

2) diçka e ëmbël

—3—

Ish një baba me grua / dhe kish një djal // një dit ajo grua ja ble di qillo portokale / i hodhi mî dullape // i muar ti hain me buk / e një një i hë ertin sa u katansën di // vate të mirr njëren //

— aman / mo më merr //

po vin një çik m e rritur na tjetra // u rrit ajo avash avash / u bëri sa kjo / u bëri sa kjo / di vjeçe / edhe zuri rrukullisej nëpër shtëpi // u rrit ajo sa u bëri për në shkoll // vij në shkoll / pson më mir na shoqet // një dit na dit vin tuke rrukullisur //

— hape / i tha së jëmës //

atje shkon djali mbretit / vete i thot së jëmës: ja vete e merr / ja u bie e des / i thot //

— qish t ua marr / i thot ajo / ata e kan marr t e han me buk //

e mori // u rrit ajo / u bëri nja dimëdhjet vjeçe / u bëri nja pesëmbëdhjet vjeçe //

na bënë një dasm / martonej biri njëj mretit tjetër // ikën kjo me kuaj e me hismeqar / se viin në një fshat tjetër // portokalen e lë më shtëpi // portokalja bën punët të tëra / dhe një të dalur bën // iqn këto // kjo kish një shënj të neruar / hodhi një qime në zjarr dhe i erdhi një / dhe i thot: dua di pal roba të kuqe metaksh dhe kal të kuq // dolli nga portokalja dhe veshi rrobat e kuqe dhe ikën // një pal i veshi një pal i mori në trast dhe i tha kalit: kok hekur e këm lepur / se do ikën / do kapton malet // vate te dasma / nusja nusëron // e mori kjo e xheshi nusen / dhe i veshi rrobat e kuqe që kish në trast / e pastaj u unj man nuses // rrij man nuses / po kjo ish m e bukur //

nën e atia djalit që kish shpur portokalen më shtëpi / tha: djali im / tha / e hodhi sevdan më një portokale / e nuk do marr nuse kurr / dhe kësaj i ra pushim zëmre // sa të njallën plakën / qimen në zjarr dhe i erdhi kali kuq / e shko / vate më portokale // kur u kthie / i tha: more djal / erdhi një vajz e bukur . . . / e tha / e ti e hodhe sevdan të një portokale e z do marrën nuse kurr //

— mir / moj nën / mir / i tha ai //

të nesërmen ikën prap me hismeqar e me takëme // portokalen e la më shtëpi / po portokalja i vate prap prapa // një kal jeshil kjo / e di pal roba jeshile / e iku atje / u unj man asaj nuses // asaj (gruas) i ra zali // sa e njallën atë / u ngre e vate në portokale // erdhi kjo // prap ashtu i tha të birit // të nesërmen prap në dasm // vete ajo // i veshi nuses një pal rroba të bardha // zali plakës // sa e njallën plakën / erdhi e u fut në portokale //

erdhi plaka në shtëpi / prap të birit //

— mir / moj nën / mir / i thot ai //

të nesërmen u ormis e vate në të lar më hamëm / portokalja bëri punët të tëra // po ki i bir i mret qënkej pshehur e duaj ta shij / bëri një banj (ajo vajza) / kisha një pus në baçe / e tha: të vete të flë një çik // po lëkurën s e veshi // pastaj e vesh / tha // s e dij q ish ai brëna // lëkosrën e portokales e la në guzhin përposh / dhe vate ra mu në krevat të djalit mretit //

ç bën ki / një të marr atë lëksrën / e një të djeg // atje tek flij kjo / një të vajt në hun er e portokales q u doq // edhe këcen më të posht e gjen portokalen te digjej //

— bobo / ç më bëre / i tha / pse ma dogje //

— nashtin do martohemi bashk / nuk je më pisk në portokale //

erdhi e jëma / i jati / dhe krici dasma //

E tregoi Tefo Hajdini,
Borsh.

—4—

I — Bagëtia / kur linën / në qoft se i vjen keq / së prapthi / çobani mundohet tja kërrej me duar / ose / po i erdhi kriq / ja kërren me gjisht dhe e tallanis / e rre për këm të pasme dhe e tun // pastaj e marr dhe mën / e vë në sis të mëmës e tia // në qoft se s pati e jëma / kulloshtër / e mën // atë tjetrën që ka pjell njësh // tuke pir më të jëmën / kaloi një muajsh¹⁾ zë ra pak bar // në qoft se e ke për të therur / e lë njëzet e pesë ditësh²⁾ dhe e ther në griq dhe i heq mullën / ose në do te maç / e lë vete di muajsh / dhe e këput / dhe mjel të jëmën //

II — E ther / e frin / i çan këmët // atje e merr më lakth // e varëm për lakthi në çerçel / ose e var më tel // s pate çerçel / e var më tel // i hap barkun edhe mërëpara kërren

1, 2) Këto përdorime rrjedhoresh në vend të rasës kallzore më tepër se një veçori dialektore më duket të jenë një përdorim i rastit i këtij personi.

dhjamët / pastaj i shkon zorrët më dor / i heq plënsin dhe i kërren mëlçin / pastaj i pret s. li-
nën me pak mëlç // pastaj merr hanxharin dhe i dan këmët //

III Çobani / në past dufek / i qëllon // s pati dufek / i nërsen qenin t i hij pas // në të
mart gjë bisha / do përpqesh me qën t ja kërrec / ose e çkre qeni një gjism ore dhe kthehet
më nome // po të ket ujç shumë të sulmon që më dark / po zakonisht e ka më di or pā dīr.

Alem Hajdini.,
Borsh

—5—

Që një plak / kishte një djal // edhe e mori atë djalën / e mori ta shpij ta mëson // ik
e ik / vate njera në mes t udhës dhe atje ndenji të prehej / dhe ja bëri uho-uh / se u lodh /
atje një të dal bëri / i dolli "an e keqç" //

— pse më fole / more plak ?

— s të fola gjë / i tha /

— ja / më fole uho-uh / Uho-uh më thon mua // ku e shpie këtë djal / i tha //

— ta shpie gjakund / ta mësoj / se e kam djal të vetëm //

— ma jep mua i tha //

— ta jap / i tha ai //

ja mori dhe ai djaln dhe ikin të di bashk // ik e ik të di bashk gjith udhën // njersa ju
afua shtëpis afër / ja mësoi të tëra ç dij Uhua // thot ai me mënden e tia : e mësova shumë /
nashi që të vete në shtëpi / do ti hedh zinxhirët e ta mbit // dhe riu brënda në shtëpi
te gruaja / dhe këtë e la në hoborr // i tha gruas: të kam prur një djal / po do të gjëj
zinxhirin ta mbit / se e kam mësuar shumë do më haj kokën //

ajo me vrap / sa të gjen ai zinxhirin / dolli jasht dhe i thot: ik / se do të mbit /
posa t ikç / se do t arrij //

ikën dhe ki // ju bë pas // hë djali / e hë Uhua / dhe vete si në Delvin // edhe atje
në Delvin që shkon / sullacojën ca zabitër / dhe një të par që i pa ki djali / i e një të bërë një
trëndafil njërit nga ata në xhep // Uhua e pa nga lart që ju bë trëndafil në xhep / e një të bër
zabit Uhua dhe u krah me ata / shetit dhe ai //

thon ata me sho shoq : ç isht ki trëndafil që mu bë mua këtu në xhep? dhe e mori në dor
i mirr er //

— nema t i marr dhe u er //

i muar er të di ata //

— neman dhe mua thotë Uha t i marr er

kur e mori Uhua që t i mirr er një të çkoqur i bëri / dhe ju bë elb dhe ju thërmua në
shesh / Uhua u bë pul të haj elbin / eibi u bë rrieth / e hëngri Uhon / dhe ja hëngri
kokën //

E tregoi Athina Baxheri
Nivicë-Bubar.

